



Filma për edukimin e hershëm gjuhësor

Këtu ju do të gjeni filma të shkurtër se si mund të mbështesni fëmijët në situata të jetës së përditshme, që të mësojnë gjuhën:

www.kinder-4.ch

Informata shtesë

Bibliotekat ndërkulturore në Zvicër

www.interbiblio.ch

Vargje në shumë gjuhë

www.vers-und-reim.net

Buchstart (Fillo librin) – Të shikoni libra me fëmijët e vegjël

www.buchstart.ch

Schenk mir eine Geschichte (Më dhuro një tregim) –

Tregime dhe më tepër në shumë gjuhë të emigrantëve

www.sikjm.ch

A keni pyetje?

Drejtohuni qendrës suaj në ndihmë të fëmijëve dhe adoleshentëve (kjj). Personeli ynë i kualifikuar ju ndihmon me kënaqësi. Këtu ju mund të gjeni të gjitha zyrat për këshillim: www.kjj.zh.ch

Pädagogische Hochschule Thurgau.

Lehre Weiterbildung Forschung



kjj | www.kjj.zh.ch



Kanton Zürich
Bildungsdirektion

kjj

Fëmijët duan të flasin – Të mbështesim mësimin gjuhësor që nga fillimi

Informacion për prindërit
dhe kujdestarët



Albanisch | Shqip

Pse gjuha është kaq e rëndësishme që në fillim?

Fëmijët kanë nevojë për gjuhën gjithmonë dhe gjithkund: në familje, duke luajtur me fëmijët e tjerë dhe gjatë mësimin në shkollë. Më vonë njohja e mirë e gjuhës ndihmon për t'u bërë një i rritur i pavarur dhe për të patur sukses. Për këtë gjë vitet e para të jetës janë shumë të rëndësishme. Shfrytëzojeni këtë mundësi!

Çfarë mund të bëni ju?

Jeta e përditshme është plot mundësi për mësimin e gjuhës. Gjashtë pikat vijuese tregojnë se si ju mund të shoqëroni dhe të mbështesni fëmijën tuaj me vëmendje.

1. Flisni sa më shumë me njëri-tjetrin në jetën e përditshme

Flisni shpeshherë me fëmijën tuaj. Për këtë ka shumë mundësi: gjatë ndërrimit të pelenave, gjatë blerjes ose në tren. Fëmijët kanë nevojë për biseda me të rriturit.

- Merrni kohë edhe për biseda të gjata.
- E rëndësishme është që të kuptoheni. Gabimet gjatë bisedës nuk janë aq të rëndësishme.

2. Lëreni fëmijën tuaj që të flasë me fëmijë të tjerë

Fëmijët mësojnë shumë gjëra gjatë lojës, edhe si të flasin. Për këtë gjë ata kanë nevojë për kontakte me fëmijë të tjerë dhe për kohë për të luajtur.

- Mundësojini fëmijës tuaj që të luajë shpeshherë me fëmijë të tjerë.
- Jepini fëmijëve hapësirë për interesat dhe idetë e tyre të lojës.

3. Të kuptoni saktë fëmijët tuaj

Fëmijët flasin sepse ata duan të na tregojnë diçka. Është e rëndësishme që ju t'i jepni kohë fëmijës tuaj dhe ta dëgjoni me vëmendje.

- Nxiteni fëmijën tuaj që të flasë.
- Tregoni interes dhe bëni pyetje derisa ta kuptoni saktë.

4. Përdorimi i shumëllojshëm i gjuhës

Me gjuhën ju mund të bëni shumë gjëra: të tregoni një përjetim, të sajoni një histori, të shpjegoni botën. Merrni kohë për këtë gjë sepse kjo është shumë e vlefshme për fëmijën tuaj.

- Flisni për gjëra që i interesojnë fëmijës tuaj.
- Ju mund të flisni edhe për mendimet ose ndjenjat.
- Shtjelloni biseda të gjata.

5. Të zbulojmë shenjat, shkrimin dhe mediat

Gjithkund ka shkrime dhe shenja: në tabela, në libra, në ekrane. Me ndihmën tuaj fëmija mund të kuptojë dhe përdorë këto sende më mirë. Kjo do ta ndihmojë më vonë gjatë leximit dhe shkrimit në shkollë dhe në botën digjitale.

- Shikoni bashkë libra më figura dhe flisni rreth tyre.
- Nëse fëmijët tuaj përdorin televizorin, telefonin mobil dhe kompjuterin: Shoqërojeni ata në këtë dhe shpjegojuani atyre mediet digjitale.

6. Të flisni në gjuhën që zotoni më mirë

Është një mundësi e madhe për fëmijët që të flasin disa gjuhë. Është më mirë, që ju të flisni më fëmijën tuaj në gjuhën që ju e dini më saktë. Kjo nuk duhet të jetë gjuha gjermane. Gjuhën gjermane fëmija juaj e mëson duke pasur kontakt me persona gjermanishtfolës. Për shembull me fëmijët e tjerë në çerdhe (Kita), në grupin e lojës (Spielgruppe) ose në familjen ditore (Tagesfamilie). Kjo do ta ndihmojë gjatë fillimit në kopsht dhe në shkollë.

- Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën tuaj për gjërat të cilat janë të rëndësishme për ju dhe që ju japin kënaqësi.
- Lëreni fëmijën tuaj që të luajë sa më herët me fëmijë që flasin gjermanisht.

